Një mendësi e re në shpërndarjen e lejeve të ndërtimit konsiderohet emergjente për Tiranën, e cila vuan nga betonizimi dhe reduktimi drastik i hapësirave të gjelbra. Zgjerimi i qytetit drejt njesive administrative përreth krijon mundësi për të shfryrë presionin për leje ndërtim ndërtim përmes zhvillimit të hapësirave të reja urbane.

Hartimi i planeve urbanistike tërësore në përputhje me kuadrin ligjor aktual të konsultimit publik si dhe transparenca e planeve urbanistike mund të ndihmojë në mbrojtjen e qytetit nga ndërtimet abuzive me apo pa leje.

3.1.3 Njesia Kashar

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, gjatë 2019, Nja. Kashar me një sipërfaqe prej 39.1 km² ka Popullsi prej 47,476 banorësh nga 39,631 banorë një vit më parë ose ndryshim 19.8 % krahasuar me vitin e kaluar, Dendësi popullsie prej 1,215 banorë/km², Moshë mesatare 33 vjeç.



Figura 8 – Harta administrative e Njesise Adm Kashar

3.1.4 Mjedi Socio-Ekonomik

Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqendrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, te të ardhurat

tatimore, të cilat në masë dërrmuese realizohen në Tiranë si dhe te zhvillimi i sektorit të ndërtimit.

Ish Komuna e Kasharit, e cila përfshihet në territorin e bashkisë së re konsiderohet zona më e industrializuar e vendit, si pasojë e përqendrimit të bizneseve dhe industrisë përgjatë autostradës Tiranë-Durrës.

Tirana rezulton bashkia me normën më të lartë të urbanizimit për kilometër katror, pas bashkisë së Durrësit.

Zonat bujqësore të Tiranës janë përqendruar në shkallë të gjerë të blegtorisë dhe prodhimet e qumështit, por edhe tek agroturizmi. Zonat kodrinore rreth Tiranës kanë gjithashtu traditë ullirine dhe drurët frutore.

Të territorin e Tiranës gjenden disa vendburime qymyrguri të pashfrytëzuara, ndërsa aktiviteti më i përhapur sa i përket shfrytëzimit të burimeve natyrore është përpunimi i gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

3.1.5 Ekonomia

Tirana është qendra më e rëndësishme industriale në Shqipëri. Për tu përmendur janë industria e lehtë dhe ushqimore si dhe industria ndërtimore, por edhe industria e ndërtimit të makinerive apo ajo e tekstileve dhe e përpunimit të qelqit. Si në të gjithë vendin ashtu edhe kryeqyteti i Shqipërisë ndodhet në një periudhë tranzicioni. Pas rrëzimit të diktaturës komuniste shumë vepra të dikurshme industriale kanë dalë pjesërisht jashtë përdorimit dhe nuk funksionojnë rregullisht. Por ndërkohë po merren masa të shpejta për rimëkëmbjen dhe vënjen sa më të shpejtë në punë të veprave ekzistuese dhe të reja. Shumica e popullsisë janë sot të punësuar në sektorin e tregtisë dhe atë të ndërtimit, në sektorin e shërbimeve publike, atë turistik dhe si punonjës të shtetit.

Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqendrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, te të ardhurat tatimore, të cilat në masë dërrmuese realizohen në Tiranë si dhe te zhvillimi i sektorit të ndërtimit.

3.2 Mjedisi Fizik

3.2.1 Gjeomorfologjia

E gjithë zona karakterizohet nga reliev fushoro-kodrinor, ku bie në sy shkalla e lartë e copëtimit horizontal, shkalla e vogël deri në të mesme e copëtimit vertikal dhe pjerrësia mesatare e shpateve. Drejtimi kryesor i vargjeve kodrinore është juglindje-veriperëndim.

Forma karakteristike e relievit që shfaqet në rajon është ajo strukturoro-erozive, që përfaqësohet nga kreshtat monoklinale dhe kuestet.

3.2.2 Gjeologjia

Rajoni në të cilin gjendet zona e propozuar për zhvillimin e projekteve bën pjesë në zonën tektonike të Krujës dhe brenda saj, në vargun e strukturave antiklinale Krujë – Dajt – gryka e Erzenit, që vazhdon edhe më në jug duke formuar krahun lindor të tyre, i cili bie drejt lindjes me kënde 30 deri 35 gradë.

Në ndërtimin litologjik të rajonit marrin pjesë depozitimet e pjesës së poshtme që përfaqësohet nga një vazhdimësi karbonatike dhe ato të pjesës së sipërme të përfaqësuara nga materiale copëzore, terrigjene dhe shtresa e pako flishore e flishoidale. Si kufi ndarës ndërmjet këtyre dy lloj formacionesh është pako mergelore kalimtare. Mbi pakon mergelore kalimtare vendoset prerja flishoro-flishoidale që ndërtohet nga një vazhdimësi shtresash terrigjene e copëzore të cilat poshtë kanë karakter flishor kurse më lart kanë karakter flishoidal. Zona e ndërtimit vendoset mbi depozitimet e Tortonianit përfaqësuar nga mollase, argjila, alevrolite, ranorë, me shtresa dhe reshpe qymyore.




Figura 9 – Pozicionimi i prones ne harte Gjeologjike.

3.2.3 Sizmiciteti

Trulli Shqiptar vendoset gjate kufirit te perplasjes se dy pllakave te medha qe levizin njera kunder tjetres; pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe eshte vater e perqendruar termetesh e cila preket me shpesh nga termete demtues. Tirana si shume zona te tjera te vendit eshte zone e prekur nga termetet, ku nga pikepamja sizmoteknike zona mund te goditet nga

termete me magnitudë $M_{max}=5.5-6.0$ grade Richter me intensitet deri në 7 balle MKS-64 e cila shkakton çarje në mur dhe rrezim të copave të suvash por për objektet e uleta nuk parashikohen shqetësime. Si dhe mundësitë për të goditur termetet me shumë balle janë të vogla rreth 20%.

3.2.4 Hidrografia

Burimet ujore sipërfaqësore

Referuar dokumentit të Strategjisë Kombëtare të ujit, Qarku i Tiranës përfshihet në pellgun ujembledhës të lumenjve Erzen dhe Ishëm, i cili formon një basen të vetëm ujorë nga gjashtë në total që ka vendi.

Lumi Ishëm formohet nga bashkimi i ujrave të lumit të Tiranës, lumit të Terkuzes dhe lumit të Zezes, ndër të cilët si dege kryesore konsiderohet lumi i Tiranës. Pellgu i tij ujembledhës pozicionohet në Shqipërinë e Mesme ndërmjet pellgut të Matit në Veri dhe pellgut të lumit Erzen në jug, vija uje ndarese me të cilin kalon nëpër malet Micaku i Shenmerisë (1828 m) dhe atë të Dajtit (1612 m). Ai ka një sipërfaqe prej 673 km² me lartësi mesatare 357 m mbi nivelin e detit, ndërsa gjatësia e shtratit është 79.2 km. Në përgjithësi të tre degët kryesore të tij dhe që rrjedhin në territorin e Bashkisë Tiranë, ruajnë karakteristikat e perrenjeve malore me rrjedhje të rrembyeshme gjatë plotave dhe me kohardhje të vogël.

Lumi Tiranës ka një gjatësi rreth 35 km dhe në pjesën e sipërme të tij formohet nga tre degë: Perroi Mojsitit, Selites dhe Zall-Bastarit. Në largësi 2.5 km nga qendra e komunës Zall-Dajt ai ndërron emrin dhe quhet lumi i Tiranës dhe vazhdon me këtë emërtim deri në afërsi të fshatit Larushk ku bashkohet me lumin e Terkuzes dhe formon lumin e Gjoles.

Degët kryesore të lumit të Tiranës janë: perroi i Lanes, i cili përshkon Tiranën nga verilindja në jugperëndim, ka një gjatësi prej 29 km, sipërfaqe ujembledhëse 67 km², lartësi mesatare 179 m mbi nivelin e detit dhe rnie 24 m/km; dhe ai i Limuthit i cili ka sipërfaqe të pellgut ujembledhës 31 km². Lumi i Tiranës furnizohet me ujë nga Selites dhe të disa perrenjeve me të vegjël me karakter stinor që derdhen në shtratin e tij.

Lumi Terkuzes rrjedh në veriperëndim të Tiranës dhe në afërsi të Fushe-Prezes bashkohet me lumin e Tiranës. Ai buron në pjesën veriperëndimore të Malit me Gropa dhe ka një gjatësi rreth 44.1 m. Pellgu i tij ujembledhës ka një sipërfaqe 182 km², lartësi mesatare 458 m mbi nivelin e detit dhe rnie 22 m/km. Përpara ndërtimit të rezervuarit të Bovilles, shtimi i rrjedhës së lumit gjatë stinës së dimrit dhe pranverës shkaktojnë përmbajtje të shumta. Me ngritjen e rezervuarit të Bovilles dhe disiplinimin e shtratit me prita e argjinaturë, ujrat e lumit të Terkuzes janë shfrytëzuar dhe shfrytëzohen për furnizimin me ujë të qytetit të Tiranës.

Lumi Zezes ka një gjatësi të përgjithshme prej 29 km. Sipërfaqja e pellgut ujembledhës të këtij lumi është 71.3 km², ndërsa lartësia mesatare 487 m mbi nivelin e detit. Lumi i Zezes dallohet për rregjim torrencial (të rrembyeshëm) dhe e siguron 68% të ujit nga reshjet që bien në pellgun ujembledhës të tij. Prurja mesatare shumë vjeçare e tij është $Q_0=2.15$ m³/s ndërsa koeficienti i rrjedhjes është 0.68 dhe për këtë arsye, në rast të prurjeve të mëdha, lumi i Zezes shkakton përmbajtje në zonat e ndodhura pranë brigjeve të tij.

Ndertimi litologjik i pellgut ujembledhes te Ishmit favorizon krijimin e nje rrjedhe te fuqishme nentokesore, e cila perfaqeson 40 % te rrjedhes se tij vjetore. Ujrat e Lumit Ishem perdoren kryesisht per ujitje.

Lumi Erzeni perfaqeson nje nder lumente e rendesishem qe pershkojne pjesen qendrore te vendit . Pellgu i lumit Erzen me siperaqe te pellgut ujembledhes 760 km² , zhvillohet ne zonen malore ne lindje dhe juglindje te Tiranës dhe ka nje lartesi mesatre 435 m mbi nivelin e detit. Erzeni buron ne afersi te qafes se Gurakuqit, ne kuton 1300 m mbi nivelin e detit dhe ka gjatesi te pergjithshme 109 km dhe prurje mesatre vjetore 18.1 m/s me nje modul te prurjes prej 24 l/s/km² . Koeficienti i rrjedhjes ujore vjetore per te gjithë pellgun e Erzenit eshte a= 051.

Si pasoje e ndertimit gjeologjik te pellgut te tij ujembledhes , formacione te papershkueshme ne 60.5 % te siperaqes, gjysem te pershkueshme ne 5 % te saj dhe 35 % e mbetur nga formacione te papershkueshme , ushqimi nentokesor perfaqeson 31 % te rrjedhjes vjetore, ndersa ai siperaqesor 69 % te saj.

Ujrat e lumit jane perdorur dhe perdoren kryesisht per vaditje dhe shume pak per uje te pijshem (pas depurifikimit) Pergjate lugines se tij ka shum puse te ceket uji qe perdoren per furnizimin me uje ne zonat rurale .




Figura 10 – Pozicionimi i prones ne Harte Hidrologjike.

3.2.5 Klima

Territori qe perfshine Qarku i Tirane perfshihet ne 3 zona klimatike: mesdhetare fushore, mesdhetare kodrinore dhe mesdhetare paramalore. Ne pjesen me te madhe te territorit mbizoteron klima mesdhetare fushore me dimer te bute dhe vere te nxehte.

Nje nga elementet baze qe karakterizon klimen e nje zone eshte regjimi i diellezimit, i shprehur me ane te nr te diteve te kthjelleta e te vraneta. Numri i diteve te kthjelleta ne territorin e Qarkut te Tiranes luhetet nga 6-7 dite ne muajt e dimrit deri ne 16-19 dite ne muajt e veres. Mesatarishte gjate vitit vrojtohen rreth 1-2 dite te vraneta ne periudhen e veres dhe 10-12 dite gjate dimrit.

Kohezgjatja mesatare e dites sipas muajve si dhe mesatarja e diteve me temperature mbi 32 °C dhe nen 0 °C

	Vjetore	JAN	SHK	MAR	PRI	MAJ	QER	KOR	GUS	SHT	TET	NEN	DHJ	Periudha studimore (vite)
Kohezgjatja mesatare e ditës (orë)	12.7	10.1	11.1	12.4	13.8	15.1	15.7	15.3	14.3	12.9	11.5	10.4	9.8	3
Nr. i ditëve me temp. > 32°C	31	-	-	-	-	-	3	11	15	1	-	-	-	3
Nr. i ditëve me temp. < 0°C	34	10	6	7	-	-	-	-	-	-	-	-	10	3

Burimi: www.weatherbase.com

Per qarkun e Tiranes rezulton se vlerat mujore te rrezatimit te pergjithshem luhaten nga 135.6 kal/cm² ne muajn dhjetor deri ne 570 kal/cm² ne muajn korrik. Shifrat tregojne nje potencial te konsiderueshem te energjise diellore per zonen ne studim , element ky shume I favorshem per zhvillimin ekonomik te zones.

Temperatura mesatare vjetore eshte 15 °C dhe kemi te bejm eme nje regjim tipik mesdhetar ku temperatura minimale vrojtohet ne muajin janar 6 °C, ndersa temperatura maksimale vrojtohet ne muajt korrik dhe gusht 24 °C.

	Vjetore	JAN	SHK	MAR	PRI	MAJ	QER	KOR	GUS	SHT	TET	NEN	DHJ	Periudha studimore (vite)
Temp. mesatare (°C)	15	6	7	8	12	17	21	24	24	20	16	11	8	3
Temp. max. mesatare (°C)	21	11	12	13	18	22	27	31	32	27	22	16	13	3
Temp. min. mesatare (°C)	9	2	2	3	7	12	15	17	17	13	10	7	3	3

Burimi: www.weatherbase.com

Ne Qarkun e Tiranes sasia e reshjeve vjetore eshte rreth 1250 mm. Ne krahasim me vleren mesatare te territorit shqiptar 1400 mm, kjo zone eshte me e ulet ne sasine e reshjeve atmosferike. Shperndrja e reshjeve gjate vitit ka nje forme “U” qe eshte tipike e nje regjimi mesdhetar te reshjeve. Sasia me e madhe e reshjeve verehet gjate periudhes se ftohte te vitit

dhe muajt me te lagesht jane Nentor-Dhjetor (162 dhe 141 mm perkatesisht) Muaji me i thate eshte korriku (38 mm)

	Vjetore	JAN	SHK	MAR	PRI	MAJ	QER	KOR	GUS	SHT	TET	NEN	DHI	Periudha studimore (vite)
Sasia mesatare (mm)	1250	120	140	100	140	140	70	30	10	40	120	150	130	3
Nr. mesatar i ditëve me shi	78	8	7	7	8	9	3	3	1	3	7	9	9	3

Burimi: www.weatherbase.com

Debora vereht rrale ne qytet dhe zonen fushore. Ajo krijohet rralle, edhe kur krijohet nuk qendron gjate, per shkak te temperaturave mbi 0 °C

Element tjetër i rëndësishëm i klimës është era. Shpejtësia e erës në territorin e qarkut të Tiranës është në varesi të periudhës së vitit. Vlerat më të mëdha të tyre vrojtohen në stinën e dimrit kur veprimtaria ciklonare është e theksuar. Rastisjen më të madhe e ka drejtimi juglindje me rastisje 15.8 % dhe veriperëndimi me 15.1 %.

3.2.6 Tokat

Bazuar në klasifikimin kombëtar Pedologjik sipas zonalitetit vertikal, brenda territorit të bashkisë vore evidentohen disa tipe tokash, ndër të cilat mbizoterojnë Tokat e Hinjta Kafë. Duke qenë të zhvilluara kryesisht në zonen perëndimore të vendit, në lartësi midis 0-200 m nga niveli i detit dhe në kushte të klimës mesdhetare kodrinore dhe fushore ato kanë edhe përhapjen më të madhe në rajonin e Tiranës, dhe mbulojnë të gjithë pjesën qendrore dhe perëndimore. Materiali primar i këtyre tokave është me natyrë të ndryshme që nga ato proluviale, dluviale dhe aluviale. Në sektoret kodrinore janë formuar Tokat e Kafenjta dhe në sektore edhe më të vecuar, më lartësi mbi 1000 m mbi nivelin e detit, Tokat e murrme pyjore.

3.2.7 Ekologjia

Në zonen në fjalë ku do ndërtohet objekti nuk ka florë dhe faunë, pasi sipërfaqja ku do ndërtohet është zonë urbane e gjitha e ndërtuar. Nuk ka hapësira të gjelbërta, si pasojë edhe faunë nuk ka. Të vetmet bimë që ekzistojnë janë ato dekorative që janë mbjelle nga bashkia Vore në trotuarët e rrugëve kryesore.

3.3 Mjedisi biologjik

3.3.1 Flora

Zona e studimit karakterizohet nga bimesia barishtore. Për këtë arsye, zona ka vlerë të ulët botanike për shkak të mungesës së llojeve bimë me status të veçantë të ruajtjes në kontekstin lokal. Si rrjedhojë, numri i llojeve faunistike që strehoen apo vizitojnë atë, është tepër i ulët dhe janë të lidhur kryesisht me habitatet kufizuese më zonën të cilët përfshijnë vendbanimet përreth,

djerrinat, si dhe shkurretat në krahun lindor dhe verior. Sipërfaqja e gjelbër natyrale është shumë e vogël dhe përfshin tapete bari dhe shumë pak lloje, si: Krisja (*Cynodon dactylon*), Mëllaga (*Pelargonium inquinans*, *Pelargonium acraeum*, *Pelargonium sp.*), dhe dredhëza e arës (*Convolvulus arvensis*). Lloje të tjera të kultivuara përfshijnë leandrin, tuja (*Thuja orientalis*), rrapin (*Platanus orientalis*), bliri (*Tilia cordata* Mill, *Tilia platyphyllos* Scop.), arra e egër (*Ailanthus altissima*) etj. Nga secili lloj drunor janë mbjellë disa individ për qëllime dekorative, kryesisht nëpër trotualet përgjatë rrugëve ndërlidhëse të zonës.

Pjesa tjetër e zonës së projektit është pjesërisht e betonizuar dhe pa vegjetacion, duke bërë që dhe diversiteti i llojeve faunistike, të jetë shumë i vogël. Megjithatë me vlerë të ulët botanike, habitatet ka rëndësi për fizionominë që i jep paisazhit urban zonës.

Zona e vlerësimit kufizohet dhe me mjedise të tjera të cilat luajnë rol të rëndësishëm në strehimin e llojeve faunistike që përdorin zonën e studimit si korridor kalimi. Ato përfshijnë:

a) Tokat djerrë përgjatë rrugëve dhe ndërtimeve urbane

Ky habitat ka shtrirje përreth zonës së studimit dhe përfshin bimësi tipike që zhvillohet në djerrinat përgjatë ndërtimit urban, si dhe anës rrugëve. Këto janë mjedise gjysmë-natyrore, të varfra në specie dhe tepër të shqetësuara nga njeriu. Llojet kryesore prezente përfshijnë: Hithrin (*Urtica dioica*), Manaferren (*Rubus ulmifolius*), Mëllagën pyjore (*Malva sylvestris*), Barin e mureve (*Parietaria officinalis*), Gjemb gomarin (*Cirsium vulgare*), Tatullën (*Datura stramonium*), Burbullakun (*Portulaca oleracea*), Lëpushkën (*Verbascum pulverulentum*), Lulediellin Evropian (*Heliotropium europaeum*), Barin mijëfletësh (*Achillea millefolium*), Hithrin romak (*Urtica pilulifera*), Ballotën e zezë (*Ballota nigra*), Lule shtogun (*Sambucus ebulus*), Labotin (*Chenopodium botrys*), Kokoçelin ngjyrë qielli (*Centaurea salnitana*), Ushqerën (*Echium italicum*), etj. Ndërkohë, lloje të evidentuara në afërsi të zonës së ndërhyrjes janë dhe Rrapin (*Platanus orientalis*), Plepi (*Populus sp.*), dhe arra e egër (*Ailanthus altissima*), si dhe bukëderri (*Cyclamen hederifolium*), këlkaza (*Arum italicum*), rudithi dy-kallizor (*Brachypodium sylvaticum*), telishi (*Dactylis glomerata*), etj.

Me përfundimin e ndërtimit të akteve rrugore kryesore është bërë dhe risistemim i kanaleve kullues, përmes instalimit të tombinove dhe betonizimit të pjesshëm të basamentit të kanalit, në të cilat rrjedhin ujërat e grumbulluara nga reshjet. Vlera e bimësisë dhe e këtyre habitateve është përgjithësisht e ulët, për shkak të diversitetit të ulët të llojeve bimore dhe mungesës së specieve që konsiderohen të jenë të rralla kontekstin lokal ose kombëtar. Hortikultura është pak e zhvilluar, si pjesë e kopshteve të objekteve private në lagjet e vjetra ose infomale të zonës, dhe përfaqësohet nga llojet si ulliri, fiku, agrumet, hurma dhe hardhi rrushi.

3.3.2 Fauna

Ndërhyrjet në habitatin natyror dhe transformimi i saj në sipërfaqe urbane ka bërë që zona në vlerësim të përfaqësohet nga numër i vogël llojesh dhe popullata me densitet të ulët të tyre. Kështu, përsa i përket grupit të reptilëve dhe amfibëve, në këtë zonë vlerësohen të pranishëm llojet si: hardhuca e murit (*P. muralis*), hardhuca e barit (*P. taurica*), breshka e zakonshme (*T. hermani*). Këto lloje frekuentojnë dhe habitatet kufizuese të tokave të hapura me bar, shkurretat,

si dhe vendbanimet përreth. Ndërkohë, të zakonshëm pranë habitateve ujore sezonale dhe rrjedhjet ujore të përkohëshme janë dhe disa lloje amfibësh, si: bretkosa e zakonshme e gjelbër (*P. kurtmuelleri*) dhe thithlopa e zakonshme (*B. bufo*). Këto lloje preferojnë me tepër habitatin e sipërfaqeve të kultivuara, në afërsi të rrjedhjeve ujore.

Si shpendë më karakteristike të kësaj zone do të përmendnim llojet e zakonshme ku përfshihen dallëndyshja bishtgërshtë, dallëndyshja bishtbardhë, dhe ajo kërbishtkuqe, bishttundësi i bardhë, harabeli i shtëpisë, gushkuqi, dervishi, kërpngrënësi, mizakapësi i përhimtë, kukuvajka, kumuria, gala, laraska, turtulli, pupeza, skifteri kthetrazi, qyqja, etj. Pjesa më e madhe e tyre është e lidhur me vendbanimet përreth.

Mammalofauna përfaqësohet nga disa lloje brejtësish të vegjël (*Rattus rattus*, *Rattus norvegicus*, *Mus musculus*). Lloje të tilla kanë si dietë ushqimet e magazinuara, mbeturinat, frutat, vemjet, etj. Si rrjedhim, ata kanë aftësi të lartë përshtatëse pranë qendrave të banuara. Ndërkohë, gjatë natës apo në kohë të zymtë, në qendrat e banuar në afërsi, mund të haset dhe pipstrela i zakonshëm (*Pipistrellus pipistrellus*) dhe lakuriq të tjerë të natës, që ushqehen me insekte dhe janë të lidhur me vendbanimet.

4 IDENTIFIKIMI DHE MASAT ZBUTESE

Identifikimi i ndikimeve të mundshme përgjatë fazës së funksionimit të impiantit

Faza ndërtimore			
Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis	Ndikimi i mundshëm
1	Cilësia e ajrit	Gjenerim pluhuri për shkak të levizjes së automjeteve. Impiantet e prodhimit të betonit janë me linjë të mbyllur dhe nuk gjenerohet me emetime, rruajtja e cimentos bëhet në sillosa apencilik dhe dozimi i saj bëhet nepermjet sistemit automatik, impiantet gjithashtu janë të teknologjise se re. Procesi është një linjë e mbyllur dhe nuk gjenerohet me shkarkime në ajër. Shkarkimet në ajër do të mund të cilësohen si të tilla vetëm përgjatë kohës së levisjes së automjeteve të ndryshme dhe auto betoniereve.	Ndikim i ulët në cilësinë e ajrit, vetëm brenda zonës së aktivitetit, ndikim i përkohshëm. Mund të kontrollohet dhe shmangët me masat e duhura të menaxhimit.
2	Zhurmë	Zhurma do të gjenerohet kryesisht nga operacionet e punës, funksionimit të impianteve, levizja dhe prania e autobetonierëve, të cilët këta të fundit do të qëndrojnë ndezur gjatë procesit dhe mbushjes së tyre me beton. Sic edhe e kemi cituar më parë në këto aktivitet nuk do të ketë zhvillime të aktiovitete të tjera si impiante fraksionimi apo linja të tjera teknologjike, linja këto të cilat shoqerohen me gjenerime shtes në komponentin zhurmë. Për këtë arsye proceset që do të shoqerohen me zhurmë përgjatë kësaj faze do të jenë më shumë zhurma të gjeneruara nga funksionimi dhe levizja e automjeteve. Impiantet e prodhimit të betonit janë në përputhje me të gjitha standartet e përputhshmërisë teknike.	Rritje e nivelit të zhurmës vetëm brenda kantierit, veçanërisht pranë burimit të gjenerimit (makineritë, automjetet). Ndikimi nuk do të jetë i ndjeshëm jashtë zonës. Ndikim përsëri do të konsiderohet i përkohshëm pasi impiantet nuk do të funksionojnë gjithmonë vetëm në nevojë të kërkesave të tregut.
3	Cilësia e ujërave	Shoqëria do të ndërtohet gjithë infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e aktivitetit këtu përfshirë edhe ndërtimin e drenazhimit apo orientimit të ujërave sipërfaqësore. Në asnjë moment rreshjet atmosferike nuk duhet të behen objekt ndikimi përgjatë fazës së funksionimit. Sic e kemi cituar edhe	Ndikim i përkohshëm dhe i ulët, kontrollohet dhe shmangët me masat e duhura të menaxhimit. Depertimi i këtyre në shtresat e tokës duke u perzier me ujrat netokesore.

		<p>më sipër lendët e para për procesin e prodhimit të betonit do të ruhen në vendet perkatëse të spëcifikuara nga drejtuesi teknik dhe në asnjë moment, rrjeshjet apo ndikimet e tjera atmosferike si era nuk do të behen objekt ndikim, ndikim ky i cili do të shoqerohej me rrjedhen dhe vershimin e ujrave sipërfaqësor.</p> <p>Shkarkimet që do të gjenerohen përgjate kësaj faze do të jene vetem ujra të cilet vijë kyresisht nga larja e automjeteve, gomave para dajles nga kantieri si edhe larja e impianteve etj. Vendqëndrimet e automjeteve do të jenë të shtruara dhe të pajisura me sistemin e drenazhimit të ujrave. Mund të ekzistojë mundësia për rrjedhje aksidentale si vajra, karburante, etj por perseri ky ndikim nuk do të konsiderohet si i tijë për shkak se shoqëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme, shtrimin e sipërfaqjes etj.</p>	<p>Nën veprimin e agjenteve atmosferike mund të orientohen drejt burimeve ujore sipërfaqësore duke perkeqësuar cilesine e tyre.</p>
4	Mbetjet	<p>Procesi i prodhimit të betonit nuk do të gjenerojë sasira të konsiderueshme persa i perket mbetjeve. Mbetjet e gjeneruara përgjatë fazes së funksionimit do të jënë kryesisht mbetje urbane të gjeneruara nga aktiviteti i stafit , mbetje keto të specifikuara si mbetje urbane. Shoqëria do të sigurojë lëndën e parë të gatëshme nga subjekte të licensusara. Impianti i prodhimit të betonit është një linjë e mbyllur e cila nëpërmjet sistemit automatik të komandimit bën të mundur peshimin dhe dozimin e lëndëve dhe më pas mbushjen e betoniereve me beton të markave të ndyshme. Për kete arsye ky proces nuk gjenerohet me gjenerim persa i perket mbetjeve.</p>	<p>Ndikim i ulet pasi keto mbetje grumbullohen ne koshat që jane vendosur ne ambientet e aktivitetit te cilet me pase shkarkohen ne kontenieret e perbashket te mbetjeve urbane ne afersi te zones te vendosur nga pushteti vendor Bashkia Vore.</p> <p>Grumbullimi dhe menaxhimi i metejshem kryhet nga firma pastruese e zones e kontraktuar nga Bashkia Tirane nga subjekte te licensuara per trajtimin e tyre.</p>
5	Mjedisi socio - ekonomik	<p>Përsa i perket aspektit ekonomik aktiviteti do të kontribuojë në punesimin e banorëve të zonës. Gjithashtu projekti i propozuar do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e</p>	<p>Ndikimi në aspektet sociale dhe ekonomike të zonës është mjaft pozitiv, duke ndikuar në rritjen e mundësive për punësim të qytetarëve dhe në zhvillimin sa më</p>

		<p>sektorit turistik, pasi zona viteve të fundit po zhvillohet me ritme shumë të shpejta, suke zgjeruar dhe shutuar dita ditës kapacitetet turistike dhe objektet e shërbimit në funksion të saj.</p> <p>Rritje e nevojës për mallra dhe shërbime.</p>	<p>të shpejtë të zonës, drejt një standarti ndryshe.</p>
6	Trafiku	<p>Shtim i trafikut në zonë për shkak të makinerive dhe automjeteve që transportojnë lëndë të parë dhe levizja e autobetoniereve. Ky ndikim do të jete i perkohshem në i ulet per faktin se aktiviteti do te funksionoj me kapacitet më të plotë pergjate periudhes së dimirit dhe me nej kapacitet shumë më të reduktuar pergjate fazës së veres, per mos të then farë përgjatë kësaj të fundit. Për këtë arsye ky ndikim nuk do te mund të quhet si i tillë.</p>	<p>Ndikim i përkohshëm i nivelit të ulët.</p>

Parandalim

- Perzgjedhja e teknologjise me cikël të mbyllur me pajtueshmeri mjedisore;
- Instalimi korrekt i makinave, sipas skemes teknologjike te permiresuar;
- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe veprimit;
- Siperfaqja e aktivitetit do te jete vazhdimisht e lagur per shmangien e ngritjes se pluhurit gjate aktivitetit;
- Kontroll i vazhdueshem për gjenerimin e pluhurit ne ajer;
- Zbatim i rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj;
- Vezhgim dhe kualidim i vazhdueshem i te gjithë teknologjise se projektit, sistem i qarrkullimit teproduktit, saracineska, tubo, valvola, tapa, guarnicione;
- Testimi periodik i teknologjise agregateve te saj.

Kontroll

- Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash;
- Kompaktesim dhe lagie e inerteve ne qiell te hapur;
- Lagie e sheshit te punes dhe rrugeve te levizjes se kamioneve ne kantier;
- Levizje e ngadalte e automjeteve ne kantier dhe jashte tij;
- Larje e shpeshte e makinerive dhe kamioneve te punes;
- Transporti i inerteve me kamion te mbuluar mbulese me Polietilieni;

Nderhyrje

- Riparim i menjehershem i difekteve dhe avarive teknologjike;
- Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhjesh te paparashikuara sipas skemes.
- Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale;
- Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash(zjarrfikes, autoambulanca)

Administrim

- Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjitha infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike.

Pluhura te shkaktuara gjate fazes se transportit

Mjetet e transportit te lendes se pare kryesisht inerteve duhet te levizin te mbuluara gjate transportit te ngarkeses, mjetet duhet tepastrohen vazhdimisht nga balta para daljes se tyre nga kantieri.

Emetim gazesh nga automjetet

Sasia do te jete minimale por duhet te punohet me eficence dhe te ulet koha e mbajtjes ndezur pa qenenevoja e motoreve te mjeteve.

Emetim zhurmash vibracioni dhe aromash

Duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet per zhurmen e shkaktuar. Edhe per kete ndikimduhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorave te mjeteve;

Menaxhimi i mbetjeve ngurta

Administrata dhe punonjesit e kantierit do ti kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne mjedis nga keqmenaxhimi i mbetjeve. Ne mjediset e kantierit jane vendosur kazane te grumbullimit te mbetjeve te krijuara nga veprimtaria e kantierit. Mbetjet shoqeria do ti dergoje sipas nje marreveshje me njesine administrative te zones ne fjale ne pike grumbullimin e mbetjeve urbane te zones.

Menaxhimi i mbetjeve te lengta

Mbetjet e lengta jane ujrat qe shkarkohen nga larjet teknologjike te skemes. Uji qe derdhet nga ky perpunim presupozohet i paster dhe nuk shkakton ndotje te mjedisit.

Programi i monitorimit dhe elementet e tij

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (DRM, Bashki etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne DRM e Qarkut sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve.

Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate procesit te funksionimit të aktivitetit, si te pluhurit ne ajer, zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor, faun dhe flore.

5 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Zbatimi i projektit nuk do te kete pasoja negative te mundshme ne mjedisin e zones.
- Perreth perimetrit te aktivitetit do te ndertohen kanalet drenazhues per ujerat atmosferike ne menyre qe te shmanget fenomeni i ndikimit, apo erozionit.
- Ky aktivitet nuk do te perdore lende te rrezikshme per shendetin e punonjesve si dhe te popullsisë perreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata.
- Ky projekt nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere .
- Gjatë procesit të levizjes se automjeteve mund te ngrihet pluhur i lehte dhe drejtuesit e shoqerise do te marrin masa per sperkatjen me uje, për paisjen e punëtoreve dhe manovratorve te mjeteve te renda me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri, si kominoshe pune, kapele mbrojtese, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri.
- Niveli i zhurmave qe vijne nga automjetet dhe pajisjet e tjera do te jen brenda normave te lejuara. Nuk perbejne problem shqetesues per punonjesit dhe as per banoret e zones perreth qe jane ne nje distance te konsiderueshme.
- Furnizimi me energji elektrike do te sigurohet nga rrjeti ekzistues qe mbulon zonen duke plotesuar te gjitha kushtet teknike.
- Per nje pune sa me optimale në impiant te zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punetoret e manovratoret njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesit teknik te firmes.

6 REKOMANDIME

Duke ditur se gjate proceseve te punes ne linje emetohen në mjedis pluhur i lehte, ka zhurma te makinerive për të rritur sigurinë në punë të punonjësve dhe per te ulur ne maksimum impaktin ne mjedis,duhet të:

- Te behet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike te automjeteve
- Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave ne mjedis.
- Te behet monitorimi periodik i emetimit te pluhurit ne ajer.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik,
- Te pastrohen dhe mirembahen kanalet e drenazhimit te ujerave perreth perimetrit te linjes.
- Te menaxhohen mbetjet e ngurta ne bashkepunim me Njesine e Qeverisjes Vendore.
- Te sigurohet furnizim i mire me energji elektrike per te reduktuar ose shmangur oret e punes segeneratorit dhe nderprejre te procesit te punes.
- Te perdoret lende djegese e cilesise se pare per gjeneratorin dhe mjetet e transportit, ku niveli isqfurit te jete brenda normes se lejuar prej 10ppm.
- Te aplikohet larja e shesheve te pa shtruara per te reduktuar pluhurin.
- Te mos depozitohet lende e pare ne sasi te medha, per te reduktuar ndikimin e mundshem ndaj kushteve atmosferike te eres dhe shiut.
- Te kryhet larja e automjeteve te transportit ne menyre periodike.
- Te vendosen kosha dhe postera sensibilizues per mbajtjen paster te ambjenteve.